

LIGJ
Nr.10 247, datë 4.3.2010

PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE¹
(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Ky ligj ka objekt përcaktimin e niveleve të KSHK-së, të tipave të kualifikimit, të objektivave, të funksioneve dhe të fushave, ku e shtrin juridiksionin e vet KSHK-ja, të strukturave përgjegjëse për drejtimin dhe zbatimin e KSHK-së, sipas përcaktimeve në këtë ligj, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, institucionet e ndryshme të pushtetit qendror apo vendor, partnerët socialë dhe organizatat jofitimprurëse, që veprojnë për zhvillimin, ofrimin dhe përdorimin e kualifikimeve, si dhe në lidhjen e KSHK-së me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe me Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Neni 2

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (në vijim, KSHK) dhe përcaktimi i parimeve dhe procedurave të krijimit, zhvillimit, zbatimit dhe përditësimit të saj për dhënien e njohjen e kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë, bazuar në standardet e njohurive, të shprehive dhe kompetencave më të gjera, që duhet të arrijnë nxënësit/kursantët/ studentët.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Aftësia” është zotësia për të zbatuar njohuritë dhe dijet, në përmbushjen e detyrave e në zgjidhjen e problemeve. Aftësia mund të jetë njohëse, kur vë në përdorim mendimin logjik, intuitiv dhe krijues, ose praktike, kur vë në përdorim shkathtësinë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave e instrumenteve.

b) “Akreditimi” është proces i pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, i cili përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë dhe/ose ofruesi i AFP-së, programet e studimit/kualifikimet profesionale që ato ofrojnë përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

c) “Grumbullimi apo transferimi i krediteve” është respektivisht procesi i marrjes së krediteve për një kualifikim dhe njohja e këtyre krediteve nga një institucion apo sistem tjetër, me qëllim transferimin e tyre drejt një kualifikimi tjetër.

ç) “Korniza Evropiane e Kualifikimeve” (në vijim KEK), është një kornizë, që përmban 8 nivele, të

¹ Ligji nr.10 247, datë 4.3.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34, datë 2 prill 2010.

Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30 maj 2018.

miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike e të tregut të punës, si dhe të nxënëit gjatë të gjithë jetës.

Tetë nivelet e kualifikimeve përshkruhen nëpërmjet rezultateve mësimore, si njohuritë, aftësitë dhe kompetencat, që përshkojnë të gjitha format e kualifikimeve.

d) “Kompetenca” është zotësia e provuar në përdorimin e njohurive, të aftësive dhe të kapaciteteve personale, shoqërore dhe/ose metodologjike, në punë apo raste studimi, si dhe në zhvillimin profesional e individual. Kompetenca përfshin përgjegjësinë dhe autonominë e veprimit.

dh) “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve” është një instrument që përmban 8 nivele, të miratuara sipas shtojcës nr. 1 të këtij ligji. Ajo shërben për klasifikimin e kualifikimeve të përfituara nga individë, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënëit dhe ka për qëllim përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë.

e) “Krediti” është njësi matëse e ngarkesës së punës së nxënësit/studentit që tregon se një pjesë e një kualifikimi është vlerësuar dhe certifikuar nga një autoritet kompetent. Numri i krediteve që përmban një kualifikim përfaqëson vëllimin e punës së kërkuar për të kryer kualifikimin ose përbërësin e tij.

ë) “Kualifikimi” është një rezultat formal i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfituar prej një organi kompetent/institucioni arsimor, të akredituar, që përcakton se individ i ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë.

f) “Niveli” është elementi thelbësor i strukturës së KSHK-së, i cili vlerësohet si një pikë e përbashkët dhe neutrale për autoritetet e arsimit dhe të formimit, në nivel kombëtar e sektorial.

g) “Njohuri” është gjithçka që arrihet, si rezultat i përvetësimit të informacionit, përmes të mësuarit. Njohuri do të thotë tërësia e fakteve, parimeve, teorive e praktikave, që lidhen me një fushë të caktuar të ushtrimit të profesionit apo të studimeve. Njohuria mund të jetë teorike dhe/ose faktike.

gj) “Standardet” janë formulimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të gjera, që duhen arritur nga nxënësit/kursantët/studentët, për të përmbushur një kualifikim.

h) “Të nxënëit formal” është një proces grumbullues i dijes, që kryhet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar, të tillë si: institucioni i arsimit të lartë, shkolla, qendra e formimit, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, ku individët, gradualisht, asimilojnë gjithnjë e më shumë entitete komplekse dhe abstrakte (koncepte, kategori, mënyra të të sjellit) dhe/ose përvetësojnë aftësi dhe kompetenca më të gjera.

i) “Të nxënëit joformal” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

j) “Të nxënëit informal” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

k) “Vlefshmëria” është procesi që siguron se standardet ose kualifikimet janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe për të përmbushur nevojat e përcaktuara e të miratuara, si dhe janë të një cilësie teknike të përshtatshme.

l) “Korniza e Kualifikimeve e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë” (në vijim, KKZEAL), është një tabelë, që përmban 3 nivele/cikle, që përshkruajnë kualifikimet në arsimin e lartë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL), me përshkruesit e përgjithshëm për çdo cikël, bazuar në rezultatet e të nxënëit dhe kompetencat, si dhe kreditet përkatëse për ciklin e parë dhe të dytë. Kjo kornizë shërben si instrument për krahasueshmërinë, transparencën dhe njohjen e kualifikimeve, lehtëson mobilitetin e studentëve në ZEAL, si dhe ndihmon institucionet e arsimit të lartë të zhvillojnë lëndët e programeve të studimit, bazuar në rezultatet e të nxënëit dhe kreditet.

ll) “Rezultatet e të nxënëit” janë një tërësi njohurish, aftësish dhe/ose kompetencash, në bazë të të cilave vlerësohet se një individ i ka fituar dhe/ose është i aftë t’i demonstrojë, pasi ka përmbushur procesin e të nxënëit.

m) “Përshkruesit e nivelit” përfaqësojnë përshkruesit e kërkuar në terma të njohurive, aftësive dhe kompetencave më të përgjithshme, për çdo nivel në KSHK.

n) “Standardet e profesionit” përfshijnë përcaktimin e tërësisë së funksioneve dhe detyrave të ushtruara në një profesion të caktuar, si dhe të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për realizimin e tyre, për të siguruar një nivel të lartë përgatitjeje.

nj) “Llojet e kualifikimit” përfaqësojnë grupe kualifikimesh, në të cilat klasifikohen kualifikimet e të njëjtit nivel të KSHK-së, të cilat kanë ngjashmëri në terma të funksioneve të tyre, të rezultateve të të nxënëit, të volumit të të nxënëit dhe/apo tipareve të tjera.

o) “Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale” është një instrument dinamik, i cili klasifikon dhe integron kualifikimet për arsimin dhe formimin profesional, të bazuara në rezultate të të nxënëit, duke identifikuar për çdo kualifikim nivelin përkatës të referencës në KSHK, duke filluar nga niveli më i madh i agregimit, që ka të bëjë me fushat e kualifikimit (drejtimet), deri në nivelin më të ulët të agregimit (nënfushat

e kualifikimit), që ka të bëjë me profilet dhe specialitetet.

KREU II KORNIZA SHQIPTARE E KUALIFIKIMEVE (KSHK)

Neni 4

Objektivat e KSHK-së

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve bazohet në këto parime:

- a) kualifikime, bazuar në rezultatet e të nxënit;
- b) fleksibilitet;
- c) marrje në konsideratë e të nxënit gjatë gjithë jetës në mënyrë formale, joformale dhe informale, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- ç) njohje dhe vijueshmëri e kualifikimeve;
- d) parimi i qartësisë, nëpërmjet përcaktimit të institucioneve që sigurojnë cilësinë e kualifikimeve të përfituara, si dhe të institucioneve zbatuese.

Neni 4/1

Objektivat kryesorë të KSHK-së

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Objektivat kryesorë të KSHK-së janë:

- a) të garantojë që kualifikimet që përfshihen në KSHK të jenë të siguruar për sa i përket cilësisë dhe të bazohen në kërkesat e tregut të punës dhe shoqërisë;
- b) të garantojë mundësi të barabarta ndaj mbajtësve të kualifikimeve;
- c) të sigurojë gjithëpërfshirjen, qartësinë dhe transparencën e kualifikimeve dhe ndërlidhjes së tyre;
- ç) të nxisë zhvillimin e kualifikimeve, bazuar në rezultatet e të nxënit, të cilat janë të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për njohuri, aftësi dhe kompetenca më të gjera;
- d) të nxisë dhe të promovojë të nxënit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë kualifikimet për zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive, si dhe mësimnxënien e të rriturve në KSHK;
- dh) të përmirësojë aksesin të kualifikimet dhe fleksibilitetin e rrugëve për arritjen e kualifikimeve;
- e) të përmirësojë progresin dhe lëvizshmërinë brenda dhe midis sistemeve të të nxënit formal, informal dhe joformal në kuadër të arsimit dhe formimit profesional;
- ë) të përmirësojë mundësinë për punësimin e individëve, sipas kualifikimit të përfitur;
- f) të inkurajojë krahasueshmërinë dhe njohjen e kualifikimeve të përfituara në Shqipëri me kualifikimet në vendet e tjera.

Neni 5

Struktura e KSHK-së

(ndryshuar pika 1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. KSHK-ja përmbledh të gjitha llojet dhe nivelet e kualifikimeve dhe certifikimit brenda një strukture prej tetë nivelesh. Nivelet, llojet e kualifikimeve dhe përshkruesit e niveleve pasqyrohen në shtojcat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij ligji. Tabela e përshkruesve të detajuar për çdo nivel të KSHK-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

2. Tetë nivelet përcaktohen nga rezultate tipike të të nxënit, të cilat gjenden në çdo nivel dhe nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me strukturën administrative të arsimit dhe të formimit ose me kohën e duhur për të arritur rezultatet.

3. Niveli më i ulët i KSHK-së është niveli 1 dhe niveli më i lartë është niveli 8. KSHK-ja identifikon edhe mënyrat e kriteret, të cilat lejojnë që individët të lëvizin nga një nivel në tjetrin, si horizontalisht, edhe vertikalisht, në të njëjtën kohë, që ata ndërmarrin studime të reja, për aftësi të reja.

4. Përparimi nga një nivel në tjetrin përcaktohet nga rezultatet e të nxënit, të cilat kërkojnë arritje në

faktorët e gjendur në çdo nivel, si:

- a) kompleksiteti e thellësia e njohurive dhe të të kuptuarit teorik e praktik;
- b) përsosja e tërësisë së shprehive të praktikuar njohëse, krijuese dhe praktike;
- c) shkalla e përgjegjësisë së pranuar dhe autonomia e treguar;
- ç) natyra e lidhjeve me praktikën akademike, profesionale dhe të punës.

5. Struktura e KSHK-së lehtëson mbledhjen dhe transferimin e krediteve brenda secilit sektor të kornizës dhe në sektorët e tjerë. Sistemi i krediteve shqiptare të KSHK-së hartohet për të siguruar mundësinë e përdorimit dhe të marrjes pjesë në sistemet europiane të krediteve.

Neni 6

Fusha e zbatimit të KSHK-së

(ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Fusha e zbatimit të KSHK-së përfshin:

- a) kualifikimet e dhëna në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e sistemit të arsimit e të formimit, përfshirë arsimin e përgjithshëm parauniversitar, profesional dhe të lartë;
- b) kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë kurset afatshkurtra për të rriturit, kurset e veçanta për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, kualifikimet e ofruara nga institucione të arsimit të lartë dhe/ose nga ofrues të tjerë të tyre dhe kualifikime të tjera të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës. Kriteret dhe procedurat për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, sipas niveleve të KSHK-së për arsimin dhe formimin profesional, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.
- c) certifikimet e rezultateve të të nxënit joformal dhe informal, në rastet kur ky i fundit certifikohet, përfshirë edhe njohjen e të nxënit të mëparshëm.

Neni 7

Funksionet e KSHK-së

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Funksionet e domosdoshme për krijimin dhe mirëfunksionimin e KSHK-së janë:

- a) akreditimi i institucioneve, të cilat ofrojnë programe, që çojnë drejt kualifikimeve të kornizës dhe vlerësojnë nxënësit/kursantët/studentët;
- b) zhvillimi, mirëmbajtja dhe vlefshmëria e standardeve të kualifikimeve;
- c) sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i nxënësve/kursantëve/studentëve;
- ç) vlefshmëria e certifikimit të nxënësve/kursantëve/studentëve të suksesshëm;
- d) menaxhimi i përgjithshëm dhe sigurimi i cilësisë së kornizës.

2. Funksionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohen nga institucionet zbatuese të arsimit të përgjithshëm, profesional dhe të lartë, të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji. Këto institucione veprojnë në përputhje me politikat e KSHK-së.

KREU III

KËSHILLI I KSHK-SË DHE INSTITUCIONET ZBATUESE

Neni 8

Ministritë përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Ministria përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së për nënsektorin e arsimit të lartë dhe nënsektorin e arsimit të përgjithshëm parauniversitar, si dhe për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës për nënsektorët përkatës është ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Ministria përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së për nënsektorin e arsimit dhe formimit profesional, si dhe për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës për nënsektorin përkatës është ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.

3. Funksionet e ministrive përgjegjëse, sipas nënsektorëve që mbulojnë, përfshijnë:

- a) planifikimin strategjik të zhvillimit dhe zbatimit të KSHK-së;
- b) mbikëqyrjen e institucioneve me përgjegjësi të caktuar për zhvillimin dhe zbatimin e KSHK-së;

- c) miratimin e dokumenteve që lidhen me KSHK-në;
- ç) hartimin dhe miratimin e politikave, që lidhen me KSHK-në dhe bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- d) raportimin periodik pranë Këshillit të Ministrave për çështjet që lidhen me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve;
- dh) miratimin e kriteve dhe procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK për nënsektorët e arsimit dhe formimit profesional. Procedurat për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale të nënsektorit të arsimit dhe formimit profesional përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional;
- e) përcaktimin e parimeve për zhvillimin e kualifikimeve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe vendosjen e prioriteteve për zhvillimin e tyre;
- ë) hartimin dhe propozimin e bazës ligjore e nënligjore në fushën e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- f) kryerjen e rishikimit të kriteve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve që përfshihen në KSHK, kryesisht ose bazuar në propozimet për ndryshime të institucioneve/agjencive të varësisë.

Neni 9

Përbërja e këshillit të KSHK-së
(Shfuqizuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Neni 10

Institucionet zbatuese dhe kompetencat e tyre
(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Institucionet zbatuese, të cilat kanë përgjegjësi të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së, janë:
 - a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional, e cila ka në kompetencë:
 - i) të kryejë periodikisht shqyrtime vlerësuese të kualifikimeve dhe t'i krahasojë ato me kualifikimet ndërkombëtare;
 - ii) të kryejë periodikisht vlerësime të tregut të punës;
 - iii) të këshillohet me palë të interesuara për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK;
 - iv) të propozojë ndryshime në kriteret dhe procedurave për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve që përfshihen në KSHK;
 - v) të hartojë, të mirëmbajë dhe të propozojë Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në arsim dhe formim profesional në bashkëpunim me komitetet sektoriale;
 - vi) të ndjekë procedurat për vlefshmërinë e cilësisë së kualifikimeve, pjesë e KSHK-së, në bashkëpunim me komitetet sektoriale.
 - b) Institucionet e arsimit të lartë bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse për punësimin dhe aftësinë, për kryerjen e vlerësimeve periodike të tregut të punës dhe punësimit të të diplomuarve.
 - c) Ministria përgjegjëse për arsimin dhe agjencitë në varësi të saj, në përputhje me përcaktimet përkatëse të kuadrit ligjor në fuqi, të cilat kanë për kompetencë:
 - i) të këshillohen me palë të interesuara për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK;
 - ii) të certifikojnë programet e studimit/ kualifikimit në përputhje me KSHK-në;
 - iii) të sigurojnë standardet dhe cilësinë e kualifikimeve në respekt të kuadrit ligjor në fuqi;
 - iv) të kryejnë periodikisht shqyrtime vlerësuese të kualifikimeve dhe t'i krahasojnë ato me kualifikimet ndërkombëtare;
 - v) të këshillojnë institucionet përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, për çështje të krahasimit apo/dhe të ekuivalentimit;
 - vi) të hartojnë dhe të mirëmbajnë regjistrat e kualifikimeve për çdo nënsektor të arsimit.

Neni 11

Komitetet sektoriale
(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Komitetet sektoriale përbëhen nga përfaqësues të ministrive përgjegjëse për sektorët përkatës të veprimtarive ekonomike, përfaqësues të shoqatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve për sektorët ekonomikë përkatës, përfaqësues të biznesit, përfaqësues të institucioneve ofruese të kualifikimeve, si dhe ekspertë të fushës. Ngritja dhe përbërja e komiteteve sektoriale miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

2. Komitetet sektoriale identifikojnë në mënyrë të vazhdueshme nevojat sektoriale për kualifikime dhe bashkëpunojnë me institucionet zbatuese përkatëse të KSHK-së për mirëmbajtjen e regjistrit të kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional.

3. Komitetet sektoriale mbështesin Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për hartimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve profesionale të përfshira në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, aprovojnë standardet e sipërcituara dhe ia përcjellin për miratim ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.

4. Përbërja e këtyre komiteteve nuk duhet të kalojë numrin e 10 anëtarëve. Numri i komiteteve sektoriale nuk mund të jetë më i lartë se 10.

5. Mënyra e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyra e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional

KREU IV SIGURIMI I CILËSISË NË KSHK

Neni 12 **Kualifikimet në KSHK** (ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Kualifikimet duhet të përputhen me praktikën më të mira ndërkombëtare, përfshirë përputhjen me nivelet, mjetet, kriteret dhe proceset e KEK-ut, të Sistemit Evropian të Krediteve në AFP (SEKAFP) dhe Sistemit Evropian për Akumulimin dhe Transferimin e Krediteve (ECTS).

2. Pjesë e KSHK-së janë të gjitha kualifikimet, për të cilat është siguruar cilësia, duke përfshirë sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së zhvillimit, ofrimit, vlerësimit dhe certifikimit të kualifikimeve profesionale.

3. Kualifikimet profesionale të AFP-së bazohen në standardet e profesioneve përkatëse dhe standardet e kualifikimeve profesionale, bazuar në rezultatet e të nxënit.

Neni 13 **Akreditimi i institucioneve dhe i kualifikimeve përkatëse** (ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Akreditimi i institucioneve që ofrojnë kualifikime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të cilat u referohen niveleve të KSHK-së, dhe akreditimi i programeve të studimit/ kualifikimeve përkatëse kryhet në përputhje me rregullat, procedurat dhe specifikimet e kuadrit ligjor në fuqi, sipas llojit të institucionit/ programit/kualifikimit përkatës.

Neni 14 **Vlerësimi dhe certifikimi** (ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Ministria përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së, për arsimin dhe formimin profesional, miraton politikën përkatëse për vlerësimin dhe certifikimin, në fushën e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

2. Institucionet që ofrojnë kualifikime sipas legjislacionit në fuqi:

- a) pranojnë dhe regjistrojnë kandidatët për kualifikim;
- b) sigurojnë vlerësime të të nxënit dhe të arritjeve të mëparshme;
- c) vlerësojnë nxënësit/kursantët/studentët dhe arkivojnë dokumentacionin për vlerësimin e tyre;
- ç) njohin kreditet e marra nga nxënësit/ kursantët/studentët, me qëllim transferimin e tyre nga programe të mëparshme studimi;

- d) marrin masa për sigurimin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve;
- dh) japin certifikata kualifikimi dhe diploma;
- e) mirëmbajnë bazën e të dhënave dhe dokumentacionin vërtetues, për miratimin e kualifikimeve dhe për certifikatat e diplomat e dhëna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Institucionet, që ofrojnë kualifikime në përputhje me legjislacionin në fuqi, sigurojnë mundësinë për vlerësim dhe certifikim të të gjithë nxënësve/kursantëve/studentëve, që plotësojnë standardet e kërkuara, përfshirë edhe nxënësit/ kursantët/studentët me aftësi të kufizuara.

4. Marrja e një kualifikimi profesional të përfshirë në KSHK përfundon me lëshimin e një diplome/certifikate nga ofrues të akredituar.

5. Në rastin e përfundimit të suksesshëm të një pjese të kualifikimit profesional, përfshirë në KSHK, ofruesi i akredituar lëshon një dokument që vërteton arritjet përkatëse.

6. Certifikata apo diploma duhet të përcaktojë nivelin dhe fushën e kualifikimit, në përputhje me nivelet e KSHK-së.

KREU V FINANCIMI

Neni 15

Burimet financiare

(shtuar fjalë në fund të nenit me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

Nevojat financiare për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji mbulohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor respektiv.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

(shfuqizuar pika 1, ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

1. Shfuqizuar.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 1, nenit 6, shkronja “b”, dhe nenit 11, pikat 1 e 5, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohen ministritë përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, në zbatim të shkronjave “c” dhe “f”, të pikës 3, të nenit 8, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6476, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

SHTOJCA 1
NIVELET E KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE (KSHK)
(ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)

KSHK	Kualifikim i përgjithshëm/ tradicional 1	Kualifikim profesional 2	Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës 3	Vijueshmëria	KEK	KK ZEAL
8	Doktoratë Shkollë studimesh pasuniversitare Studime të thelluara	Master ekzekutiv/master i nivelit të dytë/postmaster, specializim afatgjatë	Programet e studimeve të formimit të vazhduar		8	3
7	Master i shkencave Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë Program studimi i integruar i ciklit të dytë Program studimi 4-vjeçar (para hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës).	Master profesional/master i nivelit të parë.	Programet e studimeve të formimit të vazhduar	Llojet e kualifikimeve 7-1 çojnë në nivelet 8-1, 8-2 ose 8-3 Pjesë e krediteve të nivelit 7-2 mund të njihen në nivelin 7-1.	7	2
6	Bachelor Program studimi i nivelit të parë			Lloji i kualifikimit 6-1 jep akses në nivelet 7-1, 7-2 ose 7-3.	6	1
5		Program studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm. Program studimi jouniversitar, profesional pas arsimit të mesëm Certifikatë profesionale	Kurse kalimi (certifikatë) Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale	Pjesët e krediteve të nivelit 5-2 mund të njihen në nivelin 6-1.	5	
4	Diplomë e Maturës Shtetërore e lëshuar në përfundim të programit të shkollës së mesme të përgjithshme	1. Diploma e Maturës Shtetërore Profesionale, e lëshuar në përfundim të programit të shkollës së mesme profesionale. 2. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit të studimit katërvjeçar për teknikë/menaxherë të mesëm. 3. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit njëvjeçar për teknikë/menaxherë të mesëm. 4. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit dyvjeçar për teknikë/menaxherë të mesëm. 5. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të një programi çirakërie.	Kurset urë Kurset e formimit profesional Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale	Kualifikimet e nivelit 4-1 dhe 4-2 që përfundojnë me diplomë mature shtetërore japin akses në nivelin 5-2, 5-3 dhe 6-1.	4	
3		1. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit njëvjeçar për punëtorët e kualifikuar. 2. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit trevjeçar për punëtorët e kualifikuar. 3. Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të një programi çirakërie.		Llojet e kualifikimeve të nivelit 3-2 japin akses në llojet e kualifikimeve të nivelit 4.	3	
2		Certifikatë profesionale e lëshuar në përfundim të programit dyvjeçar për punëtorët gjysmë të kualifikuar.		Llojet e kualifikimeve të nivelit 2-2 japin akses në llojet e kualifikimeve të nivelit 3.	2	

1	Dëftesë lirim pas arsimit të detyruar 9-vjeçar		Kualifikimet minimale për hyrje në punë ose jetë shoqërore.	Kualifikimet në nivelin 1-1 japin akses në llojet e kualifikimeve të nivelit 2.	1
---	--	--	---	---	---

